



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.34, datë 26.06.2007

**“PËR PJESMARRJEN E BASHKISË SË TIRANËS NË PANAIRIN E
PUSHIMEVE NDËRKOMBËTARE ZVICERANE TË LUGANOS (1-4 nëntor
2007)”**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 3/II/a, III/c) si dhe nenit 19 pika 9, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.23, datë 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë së Tiranës, në Panairin e pushimeve Ndërkombëtare Zvicerane të Luganos dhe efektet financiare, sipas preventivit bashkëngjitur.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të miratojë një shtesë në shumën prej 680.140 lekësh në Buxhetin e Aparatit të Bashkisë së Tiranës (Artikulli 602) në zërin “Pjesëmarrje e Bashkisë Tiranë në Panairin e Pushimeve Ndërkombëtare Zvicerane të Luganos”, duke reduktuar në të njëjtën vlerë Fondin Rezervë për vitin 2007.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të Qytetit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R